



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË SISTEMIN E BURGJEVE
TIRANË

I. Sherbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve shpall vendet vakante.

II. Kandidatet që aplikojnë për pozicionet e punës duhet të plotësojnë kriteret bazë të mëposhtme:

• **Kriteret e domosdoshme për përzgjedhjen e aplikantit :**

- a) Të jetë shtetas shqiptar.
- b) Të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale.
- c) Të mos ketë marrë masën disiplinore përjashtim nga SHKBB, nga strukturat e tjera ligjzbatuese dhe të sigurisë kombëtare, ose të jetë larguar nga shërbimi civil dhe administrata shtetërore.
- d) Të jetë i aftë nga ana shëndetësore, e vërtetuar me vendim të Komisionit Mjeko-Ligjor.
- e) Të ketë përfunduar studimet në shkenca juridike, ekonomike, informatike ose institucionet arsimore të sigurisë.
- f) Të plotësojë kushtet dhe kriteret për t'u pajisur me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit.
- g) Të plotësojë kriteret e punës sipas pozicionit për të cilin është shpallur vendi i lirë.

• **Kritere të vecanta**

- a) Të ketë aftësi të mira analitike në njohjen e sistemeve kompjuterike.
- b) Të njohë kuadrin ligjor që normon veprimtarinë administrative, dhe kryesisht hetimin administrativ.
- c) Të ketë aftësi të mira vlerësuese dhe gjykuese.
- d) Të ketë aftësi shkrimi dhe arsyetimi ligjor.
- e) Të ketë aftësi organizative të punës në grup .

• **Procedura e aplikimit**

- a) Aplikanti dërgon kërkesën për vendin vakant.
- b) Bashkëngjit dokumentacionin për aplikim dhe i dorëzon në ambientet e Sherbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve në rrugën "Mihal Duri" Tiranë.

• **Afati për fillimin dhe përfundimin e aplikimit**

- a) Afati fillon në datë 29/12/2022 dhe përfundon me datë 15/01/2023. Pas kësaj date nuk pranohen Aplikime .

- **Dokumentacioni që kërkohet për aplikim**

Për aplikim për punonjës pranë SHKBB-së, aplikanti duhet të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse të Burimeve Njerezore dokumentacionin e mëposhtem :

- a. Kërkesën për aplikim .
- b. Fotokopje të kartës së identitetit.
- c. Kopje origjinale ose fotokopje të noterizuar te cikleve te studimit e shoqeruar me listë notash.
- d. Çertifikatë të gjendjes gjyqësore.
- e. Dy foto me përmasa 4x6 dhe dy foto me përmasa 9x13.
- f. Vërtetim nga përmbartimi gjyqësor, prokuroria dhe gjykata që nuk janë në ndjekje penale.
- g. Raport Mjeko-Ligjor mbi gjendjen shëndetësore

III. Korpusi ligjor ku duhet te referohet aplikanti :

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , e ndryshuar.
- Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë, e ndryshuar.
- Kodi i Procedurës Penale, në Republikën e Shqipërisë.
- Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë.
- Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.
- Ligji nr. 9397, date 12.05.2005, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve”
- Ligjit nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”,
- Ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”.
- Ligj nr.25/2019 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore” i ndryshuar.

IV. Pozicionet e punes te shpallura vakante jane :

- a. Specialist / Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Logjistike
- b. Specialist (Për Burimet Njerëzore) /Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Logjistike
- c. Inspektor pranë I.E.V.P Shkodër / Sektori i Hetimit Lezhë, Shkodër, Kukës dhe Burrel.
- d. Inspektor pranë I.E.V.P Tepelenë / Sektori i Hetimit Fier, Vlorë, Berat, Lushnjë dhe Tepelenë.